



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UJESJELLES KANALIZIME KUKES SH.A
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

V E N D I M

Nr. 468 Prot,

Date 23 / 05 / 2023

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME TË SHOQËRISË

UJESJELLES KANALIZIME KUKES SH.A

Sot, më datë 23 Maj 2023, Ujesjelles Kanalizime Kukës sh.a, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J67902228S, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë zoti Afrim Elezi, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

Çështjet e rendit të ditës:

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim.
- Emërimi i Likuidatorit.

Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:

Shoqëria Ujesjelles Kanalizime Kukës sh.a nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr. 1540 Rep. dhe Nr. 687Kol, datë 07.11.2022 midis shoqërisë Ujesjelles Kanalizime Kukës sh.a dhe shoqërisë Shoqëria Rajonale Ujesjellës Kanalizime Kukës sh.a, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 1.1.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja vendosi:

- (1) Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
- (2) Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
- (3) Emërimin e Z. Afrim Elezi si likuidator të shoqërisë.
- (4) Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me

legjislacionin e aplikueshëm për likudimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likudimin e shoqërisë.

Pasi u siguroa se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon.

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

KRYETAR

Safet GJICI

